



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. _____ prot

Tiranë, më _____.____2025

Kriteret dhe specifikimet teknike të ambjenteve, për të cilat do të merren oferta nga personat e tretë, fizikë/juridike private

I. Kriteret ligjore që duhet të plotësojnë ofertuesit:

- Të jenë titullarë të ligjshëm të pronës të vërtetuar me certifikatë pronësie, lëshuar nga ASHK-ja bashkë me kartelën dhe hartën shqoëruese të pronës, si dhe genplan-in;
- Vetëdeklarim hipotekor që prona nuk është në sekuestro dhe është e lirë nga çdo barrë hipotekore apo detyrim tjetër ligjor;
- Vetëdeklarim nga FSHU-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit të energjisë elektrike.
- Vërtetim nga UKT-ja që nuk ka detyrime të pashlyera dhe kopje të kontratës së furnizimit nga ujësjellës-kanalizimet.
- Vërtetim që ofertuesi nuk është në ndjekje penale apo proces gjyqësor.
- Kopje ID e titullarit të pronës/ambienteve.
- Vërtetim të numrit të llogarisë bankare në një nga bankat e nivelit të dytë në RSH.
- Ofertë me shkrim e çmimit të qirasë së ambienteve, në muaj.
- Vetëdeklarim për plotësimin e të gjitha kërkesave dhe kriterëve ligjore-teknike që kërkohen nga Zyra e Komisionerit (qiramarrmarrësi).

Nëse është tregtar/shoqëri tregtare duhet të paraqesë edhe:

- Vërtetim nga tatim-taksat që nuk ka detyrime të pashlyera;
- Vërtetim që nuk ka sigurime shoqërore të pashlyera nga e-sigurime;
- Ekstrakt QKR-je që vërteton se ka status aktiv.

II. Kërkesat specifike të ambienteve objekt qiramarrje:

- Sipërfaqja në total e ambienteve të brendshme të jetë 90 m² – 100 m²;
- Ambienti të ofrohet nga një subjekt zotërues i pronës, por në total i gjithë ambienti duhet të jetë jo më shumë sesa sipërfaqja e parashikuar në pikën 1, kreu II.

- Ambienti duhet të jetë sa më pranë godinës ekzistuese dhe jo më shumë se 100 metra në vijë ajrore larg godinës së “Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, në adresën “Rruga Abdi Toptani”, nd.5 Tiranë.
- Objekti/ambientet duhet të kenë të instaluar sistemin e vëzhgimit me kamera brenda dhe jashtë.
- Ambienetet e brendshme të jenë “Open Space” të përshtashme dhe të ofrojnë funksionalitet/ndarje për të sistemuar postet e punës së punonjësve të Zyrës së Komisionerit
- Objekti duhet të ketë furnizim me ujë dhe energji elektrike 24/7 dhe të jetë i pajisur me matësit e ujit dhe të energjisë elektrike.
- Objekti duhet të jetë i përfunduar me dyer, dritare, i lyer dhe i gatshëm/i lirë për t’u shfrytëzuar nga qiramarrësi.
- Objekti/ambientet duhet të ketë sistem kondicionimi dhe ajrimi, të instaluar dhe plotësisht funksionale.
- Ambjentet duhet të jenë bosh dhe i lire, dorëzimi i objektit do të bëhet brenda 5 ditëve nga njoftimi për lidhje kontrate.
- Ambientet/objekti në total duhet të kenë minimalisht 2 tualete të kompletuara me pajisjet hidrosanitare dhe pajisjet për ujë të ngrohtë.
- Ofertuesi duhet të përcaktojë çmimin (oferta ekonomike), vlerën mujore të qirasë për një muaj, duke përfshirë të gjitha detyrimet tatimore sipas legjislacionit në fuqi.
- Përzgjedhja e ofertës ekonomike do të bëhet duke vlerësuar çmimin me të favorshëm si dhe plotësimin e kriterëve të përcaktuar më sipër.
- Afati i kontratës së qiradhënies të jetë jo më pak se një vit me të drejtë rinovimi. Afati do të përcaktohet gjithmonë nga qiramarrësi, i cili njofton me shkrim 30 ditë para mbarimit të kontratës qiradhënësin.

III. Paraqitja e dokumentave dhe ofertës së qirasë së ambienteve

-Dorëzimi i dokumenteve dhe ofertave ekonomike duhet të bëhet brenda datës **26 nëntor 2025, ora 16:00**, me postë ose dorazi pranë institucionit të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në adresën “Rruga Abdi Toptani”, Nd.5 Tiranë.

Për çdo komunikim apo sqarim, lutemi na shkruani në adresën elektronike info@idp.al.